

P. nr.472/16

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. L. nga fsh.P. KK Deçan, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378/7-6 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore- DP në Gjakovë, PP.nr.825/15 të dt.04.08.2016, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **01.12.2016**, në prani të Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj, të dëmtuarve M. dhe K. J. si dhe të akuzuarit B. L., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **B. L.**, i biri i H. dhe i nënës H. e gjinisë B., i lindur me dt. ... ne Deçan. me banim n e fsh. P., KK Deçan, ka te kryer shkollën e lartë, i pa punë, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i martuar at i 4 fëmijëve .

**Ë s h t ë f a j t o r****Sepse :**

- me dt. 16.06.2015, rreth orës 17.20, në rrugën Gjakovë –Junik, duke drejtuar automjetin e markës “Ford” me targ. Regj. ...-EF, ngjyre e hirte metalike, nuk e përshtat shpejtësinë e lëvizjes, kushteve e rrethanave ne rrugë, nuk e mban distancën e mjaftueshme te sigurisë, e në kundërshtim me nenin 54 parg. 5/1 dhe nenin 126 parg. 2/1 te LSKRR-ës, rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që me të arritur ne fsh. M. KK Gjakovë, duke mos mbajtur distancën e mjaftueshme, me pjesën e parë të automjetit nga pas e godet automjetin e markës “Opel-Cadet”,me targ. Regj. ...-AC, ngjyre e kuqe e bardh, nga kjo e dëmton automjetin e tij ndërsa të dëmtuarit M. M. J. nga Gjakova ,rruga “...” hyrja ..., i shkakton dem material ne automjet dhe lëndime te lehta trupore si dhe pasagjeres te dëmtuarës K. J. nga Gjakova i shkakton lëndime te lehta trupore te përshkruara sipas ekspertizës mjeko ligjore nr. 21/16 te dt. 03.08.2016 te dr. F. D. .

**-me çka ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378/7-6 të KPRK-së**

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,17,41,49,50,51, 73 ,neni 378/7-6 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton :

**DENIM ME KUSHT**

Dënim me burgim ne kohëzgjatje prej **3 (tre ) muajve**, i cili dënime nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Të dëmtuarit M. dhe K. J., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër shpenzimeve procedurale te paguaj shumen prej **90.88 euro** si dhe ne emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20 ,00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.825/15 të dt.04.08.2016, e ka akuzuar të akuzuarin B. L. nga fsh. P. KK Deçan, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378/7-6 të KPRK-ës, duke propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Gjatë shqyrtimit fillestar me dt.01.12.2016, përfaqësuesi i PTH-DP, në Gjakovë, Prokurori Ismet Tofaj lexon aktakuzën PP.nr.825/15 të dt.04.08.2016, dhe deklaroi se mbetet në tersi pran aktakuzës. Lidhur me pranimin e fajësisë, prokurori i shtetit deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorët juridike të pranimit të fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndes.

I akuzuari B. L. gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me parë pasojat e pranimit të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion dhe shtojë se fajësinë e kam pranuar në çdo fazë të procedurës, jam penduar për veprën e kryer nga pakujdesia, në të ardhmen do të jem me kujdes të mëtejshëm, kërkoj falje para gjykatës nga të dëmtuarit për demin e shkakuar, andaj i propozoi gjykatës që të marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe të më shqiptojë një dënim me të butë nga se është hera e parë që kam rënë në ndesh me ligjin.

I dëmtuari M. J., deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i akuzuari, nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale, por kërkesën pasurore juridike do ta realizojë nga kompania e sigurimeve.

E dëmtuara K. J., deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i akuzuari, nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale, por kërkesën pasurore juridike do ta realizojë nga kompania e sigurimeve  
Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari B. L., me dt. 16.06.2015, rreth orës 17.20, në rrugën Gjakovë – Junik, duke drejtuar automjetin e markës “Ford” me targ. Regj. ...-EF, ngjyre e hirtë metalike, nuk e përshtat shpejtësinë e lëvizjes, kushteve e rrethanave në rrugë, nuk e mban distancën e mjaftueshme të sigurisë, e kundërshtoi me nenin 54 paragrafi 5/1 dhe nenin 126 paragrafi 2/1 të LSKRR-ës, rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që me të arritur në fsh. M. KK Gjakovë, duke mos mbajtur distancën e mjaftueshme, me pjesën e parë të automjetit nga pas e godet automjetin e markës “Opel-Cadet”, me targ. Regj. ...-AC, ngjyre e kuqe e bardhë, nga kjo e dëmton automjetin e tij ndërsa të dëmtuarit M. M. J. nga Gjakova, rruga “...” hyrja ... , i shkakton dëm material në automjet dhe lëndime të lehta trupore si dhe pasagjerës të dëmtuarës K. J. nga Gjakova i shkakton lëndime të lehta trupore të përshkruara sipas ekspertizës mjeko ligjore nr. 21/16 të dt. 03.08.2016 të dr. F. D. .

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vetë pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të se cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka arritur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPK-ës. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka arritur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, karakteristikat personale te akuzuarit se është baba i 4 fëmijëve, pendimin e tij, sjelljen korrekte në gjykim, gjendja e varfër ekonomike, si dhe faktin se i njëjti me pare nuk ka qene i dënuar nga ana e gjykatës. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatja prej **3 (tre)** muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës se dëmtuar ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar ne nenin 463/2 te KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.472/16 më datë 01.12.2016.**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës se Apelit ne Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.